



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" nr.1, Tiranë; Tel: 04251-267,

e-mail: klsh@klsh.org.al, web-site www.klsh.org.al

Nr.177/12 Prot.

Tiranë, më 14.09.2021

V E N D I M

Nr. 111, Datë 14.09.2021

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË THESARIT
"MBI PËRPUTHSHMËRINË" PËR PERIUdhËN NGA DATA 01.01.2020 DERI MË
DATËN 31.12.2020.

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, rezultoi se sistemet e kontrollit në sistemin e thesarit, përgjatë të gjitha hallkave të programimit dhe ekzekutimit të buxhetit, ka devijime materiale dhe të përhapura, jo në përputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe të planit të veprimit", i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi përputhshmërinë në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit", sipas Programit të Auditimit nr. 177/1 prot., datë 12.02.2021, i ndryshuar, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2020, me afat auditimi nga 08.02.2021-27.04.2021.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi përfunduar auditimin e përputhshmërisë së aktivitetit të sistemit të thesarit për vitin 2020, bazuar në Sistemin Informatikë Financiar të Qeverisë (SIFQ), nëpërmjet të cilit Qeveria e Republikës së Shqipërisë kryen të gjitha proceset e ekzekutimit dhe raportimit financiar të Buxhetit të Shtetit.

Opinionit i Auditimit mbi Përputhshmërinë

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, justifikojnë dhënien e opinionit.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit, mbi të cilat janë formuluar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, përmbledhur në bazën për opinion, si rrjedhojë e ekzekutimit të procedurave audituese, rezulton se sistemet e kontrollit në sistemin e thesarit, përgjatë të gjitha hallkave të programimit dhe ekzekutimit të buxhetit, ka devijime materiale dhe të përhapura, jo në përputhje me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, VKM nr.50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe të planit të veprimit”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e **Opinionit të kundërt mbi përputhshmërinë**.

Baza për Opinionin e kundërt

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000)

Në vijim:

Gjatë vitit 2020, në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, janë konstatuar përmirësime në zbatimin e kontrolleve të parashikuara në lidhje me administrimin e operacioneve të zbatimit të buxhetit të shtetit nëpërmjet sistemit informatikë financiar qeveritar (SIFQ), në raportimin periodik të shkeljeve të konstatuara në lidhje me cilësinë dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga ana e njësisve shpenzuese, kjo edhe në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të mëparshme të KLSH-së. Pavarësisht përpjekjeve, gjatë vitit 2020, niveli i thyerjeve të sistemeve të kontrollit dhe masave parandaluese, detektuese, dhe korigjuese që do të garantonin disiplinimin fiskal të sektorit publik mbetet material dhe i përhapur në të gjitha hallkat miratuese dhe zbatuese.

Njësitë shpenzuese vijojnë të mos marrin miratimin e Thesarit përpara fillimit të procedurave të prokurimit, dhe mos raportimin e saktë dhe në kohë të angazhimeve dhe shpenzimeve buxhetore. Gjithashtu u konstatua, që strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,

¹ ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: “Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme”

megjithëse në dijëni të shkeljeve nga njësitë shpenzuese, si në rastet e shkeljeve të afateve të regjistrimit të angazhimeve dhe shpenzimeve, nuk kanë marrë asnjë masë administrative konkrete për të disiplinuar procesin në mënyrë efikase dhe në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Ndërkohë këto struktura kanë kontribuar në krijimin e mundësive për kapërcimin e kontrolleve si në rastin e mos regjistrimit të planit të buxhetor sipas PBA-së, apo regjistrimeve të urdhër- prokurimeve, kontratave, dhe faturave në SIFQ për shkak të mungesës së fondeve buxhetore disponibël.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë- Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për administrimin e sistemit të thesarit, në përputhje me Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, VKM nr.50 datë 05.02.2017 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre. Drejtimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit të njërive shpenzuese në sistemin e thesarit me kriteret e vlerësimit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse funksionimi i sistemit të thesarit nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit të sistemit të thesarit për vitin 2020, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne: Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuar, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

Krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale, por jo duke pasur si qëllim kryesor dhënien e një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me sistemin e thesarit.

Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të regjistrimit, ekzekutimit dhe raportimit në sistemin e thesarit janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga analizimi i të dhënave të vëna në dispozicion, mbi rishikimet buxhetore përgjatë vitit 2020, u konstatua se ka patur **rreth 2327 rishikime** të fondeve buxhetore **me një ndryshim buxheti prej 50.7 miliard lekë**, nga të cilat 632 rishikime prekin investime kapitale dhe 1695 për shpenzime korrente. Sipas Udhëzimit të përhershëm të MF nr. 2 datë 06.12.2012, të ndryshuar, pika 79, në bazë të numrit të lartë të rishikimeve mund të konkludojmë për një planifikim të dobët të shpenzimeve për investime ashtu edhe ato për shpenzime operacionale, nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, mungesës së analizave të mirëfillta para planifikimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, mungesë monitorimi i zbatimit të buxhetit dhe veçanërisht të ecurisë së zbatimit të investimeve.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë përgjegjëse: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin në kuadër të zbatimit të Metodologjisë për Monitorimin e Investimeve Publike, të marrë në konsideratë përfshirjen e numrit të rishpërndarjeve të kërkuara nga çdo njësi në grupin e treguesve të matjes së performancës financiare me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe cilësisë së programimit buxhetor.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, u konstatua regjistrimi i rialokimeve me data kontabël, efektive më të hershme (retrospektive). Referuar

Udhëzimit standard për zbatimin e buxhetit, detajimi i buxhetit dërgohet zyrtarisht tek çdo njësi qendrore dhe bëhet i vlefshëm për zbatim vetëm pasi regjistrohet në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) nga struktura përgjegjëse për buxhetin. Çdo regjistrim kalon nëpër disa faza miratimi. Kështu sipas Urdhrit nr. 62 datë 31.08.2010 “Për zbatimin e operacioneve ditore në sistemin e Thesarit” ku parashikohen hapat e nevojshme të kontrollit për shmangien e gabimeve në regjistrim.

Gjithsej janë konstatuar 181 regjistrime datat efektive të të cilave janë të një ose disa muajve më të hershëm, nga të cilat 52 raste janë regjistruar në vitin 2021, me datë efektive vitin 2020. Diferenca ndërmjet regjistrimit dhe datës efektive arrin deri në 1 vit.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë e saj përgjegjëse, në rolin e ekzekutuesit dhe/apo miratuesit, të analizojë dhe investigojë të gjitha rastet e regjistrimeve me data retrospektive të rishpërndarjeve buxhetore të vitit 2020, duke vlerësuar nëse këto raste janë kryer para apo pas ndërmarrjes së veprimeve për këto investime.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të rishikimeve buxhetore, u konstatua se janë kryer 442 rishikime pas datës 15 nëntor të vitit 2020, veprim në kundërshtim me nenin 48 “Afati për rishpërndarjen e fondeve buxhetore” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku citohet: “*E drejta e njëjësive të qeverisjes së përgjithshme për rishpërndarjen e fondeve, të miratuara për vitin buxhetor, ushtrohet deri në datën 15 nëntor të çdo viti buxhetor*”. Institucionet të cilat kanë pasur më shumë rishikime pas datës 15 nëntor janë: Bashkia Tiranë, ARRSH, Aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, FSHZH etj. Vlen për tu theksuar se ndryshimet buxhetore që prekin vitin 2020 vazhdojnë deri në datën 24 shkurt 2021, edhe pse ligjërisht pagesat me efekt kontabël 2020 lejohen deri në datën 21 janar 2021, çka vërteton se regjistrimet në këto raste kryhen *post factum*.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë me drejtoritë e saj përgjegjëse, në rolin e ekzekutuesit dhe/apo miratuesit, të analizojë dhe verifikojë të gjitha rastet e regjistrimeve pas datës 15 nëntor të rishpërndarjeve buxhetore të vitit 2020 për të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë përkatëse.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi shpërndarjen e planit të pagesave të kontratave për projekte investimesh në SIFQ konstatohet se janë regjistruar plan pagesash në vitin 3 për **17 projekte në shumën 3.7 miliard lekë**, pa asnjë plan pagese për vitin aktual, vitin 1 dhe vitin 2. Regjistrimi në këtë vit të këtyre projekteve të investimeve është kryer në kushtet e mungesës së fondeve buxhetore të miratuar për angazhime të ndërmarra në vitin aktual apo vitet e mëparshme buxhetore, pasi nuk është e mundur që angazhimet të ndërmarra me kontrata përkatëse, të mos parashikohen që të ekzekutohen përgjatë 2 viteve të ardhshme buxhetore. Disa nga këto projekte nuk kanë fonde në fillim të vitit, por u alokohen fonde gjatë vitit nëpërmjet rishikimeve.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Drejtoria e përgjithshme e Thesarit, të analizojë dhe verifikojë të gjitha rastet e konstatuara me plan pagesash vetëm në vitin 3, pa asnjë plan pagese për vitin aktual, vitin 1 dhe vitin 2 për të nxjerrë arsyet dhe përgjegjësitë përkatëse.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga kryqëzimi i të dhënave të vëna në dispozicion nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) mbi procedurat e prokurimit të iniciuara në vitin 2020, dhe të dhënave mbi kontratat e regjistruara në SIFQ, u konstatua se ka mospërputhje midis tyre. Ekzistojnë kontrata në APP, të cilat nuk rezultojnë në SIFQ, dhe anasjelltas, ka kontrata në SIFQ të cilat nuk rezultojnë në APP.

Në SIFQ gjatë vitit 2020, rezultojnë 743 rekorde unike të dokumentit urdhër-prokurim me vlerë totale 74 miliard lekë, nga rreth 24 mijë kontrata të regjistruara gjatë vitit 2020 (referuar regjistrimit të kontratave), pasi njësitë ekonomike, me ose pa akses në SIFQ, nuk regjistrojnë në çdo rast pranë degëve të thesarit urdhër-prokurimet para fillimit të procedurave në APP.

Gjithashtu, në vijim të kësaj problematike, u konstatua se:

- 197 nga 743 urdhër-prokurime të regjistruara me datë viti 2020, rezultojnë të lidhura me një kontratë të nënshkruar në vite të mëparshme (2011-2019) pra procedura e prokurimit ka përfunduar para se urdhër-prokurimi të regjistrohet në SIFQ dhe regjistrimi në SIFQ është formal dhe në shkelje të afateve ligjore.

- 550 nga 743 urdhër-prokurime, kanë datë kontrate përpara datës së regjistrimit të urdhër-prokurimit, çka do të thotë se për këto prokurime regjistrimi në SIFQ bëhet pasi ka përfunduar procedura e prokurimit dhe është lidhur kontrata, duke cënuar kontrollin për marrjen e angazhimeve buxhetore pa fonde disponibël dhe rrjedhimisht krijimin e stokut të faturave të prapambetura.

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik në vijimësi të rakordojnë të dhënat mbi regjistrimin e prokurimeve nga institucionet buxhetore, duke evidentuar dhe raportuar ndryshimet midis këtyre databazave, dhe nxjerrë përgjegjësitë institucionale tek Nëpunësi i Parë Autorizues (NPA).

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga kryqëzimi i të dhënave të APP mbi procedurat e prokurimit të iniciuara në vitin 2020, me të dhënat e afishuara në web-in e Ministrisë të Financave për PBA-në e institucioneve qendrore, u konstatuan **7 raste me vlerë fondi limit 4.27 miliard lekë, ku janë marrë angazhime pa fonde buxhetore disponibël për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA**, veprim në kundërshtim me Udhëzimin plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, pika 19/e: *Projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së 2019-2021*”. Nga këto, vlerën më të lartë e zë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me 2.4 miliard lekë, ndërkohë Ministria e Mbrojtjes ka numrin më të lartë të rasteve me 3 të tilla. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Kulturës dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit kanë zhvilluar nga 1 procedurë pa fonde disponibël.

6.1 Rekomandimi: Nëpunësi i Parë Autorizues të vlerësojë dhe të marrë masa për rastet e evidentuara të marrjes së angazhimeve pa fonde buxhetore disponibël për projekte pa kaluar në procesin ligjor të miratimit në PBA, veprime në kundërshtim me Udhëzimin plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2020”, pika 19/e.

Gjithashtu për sa i përket kufizimit të auditimit në lidhje me këtë problematikë si pasojë e mospublikimit të PBA për institucionet si AKSHI, ARRSH, AKUIM, të merren masa për publikimin e tyre në web-in e MFE.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga kryqëzimi i të dhënave të APP me ato të SIFQ, u konstatua se nga 42 prokurimet të cilat rezultojnë të zhvilluara nga Aparatet e Ministrive, **13 procedura** me vlerë fondi limit **2.85 miliard lekë**, janë zhvilluar pas datës 15 tetor pa qenë pjesë e buxhetit tre vjeçar, veprim në kundërshtim me nenin 51, pika “g” e Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, i ndryshuar, dhe me nenin 2 të VKM nr. 807 datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike”, pika. 2.

7.1 Rekomandimi: Nëpunësi i Parë Autorizues të vlerësojë dhe të marrë masa për rastet e evidentuara ku janë zhvilluar procedura pas datës 15 tetor pa qenë pjesë e buxhetit tre vjeçar, veprim në kundërshtim me nenin 2 të VKM nr. 807 datë 16.11.2016 “Për disiplinimin e angazhimeve buxhetore publike”, pika. 2.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i databazës së kontratave, u konstatua se nga 23,660 kontrata të regjistruara në total, **14982 kontrata ose 63%** e totalit të kontratave të regjistruara me vlerë **131.5 miliard lekë** janë regjistruar në shkelje të afatit 5 ditor, në kundërshtim me pikën 144 të Udhëzimit i Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar. Fenomeni i regjistrimit me vonesë i kontratave vazhdon të shfaqet edhe këtë vit si në njësitë e qeverisje vendore ashtu dhe në ato qendrore, përfshirë dhe institucionet e pavarura. Nga këto 2,202 kontrata janë për investime kapitale dhe 12,780 për shpenzime korrente. Nga analizimi i mëtejshëm i të dhënave rezultoi se gjatë vitit 2020 janë regjistruar **2,564 kontrata** në vlerën totale **52 miliard lekë** të cilat i përkasin viteve të mëparshme. Kontrata më e hershme e regjistruar në vitin 2020, rezulton të jetë lidhur në vitin 2007, pra **13 vite më parë**, pra këto kontrata regjistrohen me qëllim shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Gjithashtu, nga verifikimet e të dhënave ndërmjet APP dhe SIFQ rezultoi se numri i kontratave nuk përputhet. Jo të gjitha kontratat që janë regjistruar në SIFQ, mund të gjenden në APP në të njëjtin vit, si dhe jo të gjitha kontratat e APP mund të gjenden në SIFQ, në kundërshtim me Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar. Nga sa më sipër rezulton se plotësia dhe saktësia e data bazës së Thesarit nuk jep siguri për angazhimet buxhetore të ndërmarra, pasi kontratat nuk pasqyrohen në koherencë të plotë.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në vijimësi të evidentojë rastet e regjistrimit të kontratave me vonesë, duke evidentuar rastet më problematike dhe t’i raportojë ato tek NPA.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan **32927 fatura** në total me vlerë **45.4 miliard lekë** të dorëzuara në thesar jashtë afatit 30 ditor, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) “parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit”. Ndër institucionet më problematike përmendim Bashkinë Tiranë me 2542 fatura të dorëzuara jashtë afatit ose 7.7 % e totalit të rasteve të konstatuara, AKSHI me 1342 fatura ose 4% e totalit të rasteve të konstatuara, dhe ARRSH me 734 fatura ose 2.2% e totalit të rasteve të konstatuara.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të evidentojë vazhdimisht rastet e regjistrimit të faturave me vonesë dhe ti raportojë ato tek Nëpunësi i Parë Autorizues, duke marrë masat administrative të parashikuara në ligj për këto raste për Nëpunësat Autorizues dhe Nëpunësat Zbatues, me qëllim përmirësimin e këtij treguesi në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të transaksioneve të procesuara në sistemin SIFQ u konstatuan **66 raste me vlerë 122 milion lekë** të tejkalimit të afatit të procesimit dhe ekzekutimit të pagesave, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a) “parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit”.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të evidentojë vazhdimisht rastet e ekzekutimit të faturave me vonesë, dhe ti raportojë ato tek NPA duke marrë masat administrative të parashikuara në ligj për punonjësit që kanë shkaktuar vonesat, me qëllim përmirësimin e këtij treguesi në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan 79 raste të regjistrimit dhe pagesave pjesore të faturave, kjo me qëllim përputhjen e fondeve buxhetore disponibël të cilat janë më të vogla se sa vlera e detyrimit të lindur. Me paraqitjen e faturës dhe urdhër-shpenzimit nga njësitë buxhetore, regjistrimi nga degët e Thesarit është bërë pjesor duke rezultuar në pagesa pjesore, me vlerë të barabartë me fondet disponibël. Pavarësisht numrit të vogël të rasteve të konstatuara, KLSH thekson efektin e detyrimeve të prapambetura në kushtëzimin e procesimit të transaksioneve të pjeseshme në sistem, veprime që nuk japin siguri për vlerën reale të shpenzimeve apo investimeve të raportuara. Ndër institucione me më shumë raste të konstatuara, janë Bashkia Tiranë me 42 raste, INUK me 14 raste dhe Spitalin Peqin me 9 raste.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të evidentojë vazhdimisht rastet e regjistrimit të faturave pjesore, dhe ti raportojë ato tek NPA, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësiive individuale dhe marrjen e masave për këto raste. Gjithashtu nga DPTH të merren masat e nevojshme për mos lejimin e regjistrimit të faturave pjesore.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Lidhur me respektimin e procedurave të radhës së prioriteteve të pagesës (FIFO), u konstatuan ekzekutime të pagesave të faturave të regjistruara në data të mëvonshme, përpara urdhër shpenzimeve të regjistruara në data më të hershme. Ekzekutimi i faturave kryhet në çdo rast nga dega e thesarit, edhe në rastin e institucioneve që kanë BI online. Nga një analizë e përgjithshme mbi popullatën e të dhënave, u konstatua se devijimet më të shumta i përkasin degës së thesarit Tiranë. Ndërsa rastet e kontstatuara në degët e tjera janë raste të izoluara.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të marrë masat e nevojshme për kontrollin e vazhdueshëm të kryerjes së pagesave me qëllim trajtimin e barabartë të furnitorëve, në zbatim të parimit FIFO.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të llogarisë 466 “Garanci të punimeve” të regjistruara në sistemin SIFQ gjatë vitit 2020, duke vlerësuar të dhënave të fushës “Përshkrimi” mbi datën e akt-kolaudit dhe datën e procesverbalit përfundimtar të marrjes në dorëzim, u konstatuan:

- **2 raste** pagesash me vlerë **1,148 mijë lekë** në shkelje të afatit 1 vjeçar nga data e akt-kolaudit, në kundërshtim me udhëzimin nr. 3 datë 15.01.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, seksioni “II. Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, në pika 6 dhe 8.

- **40 raste pagesash me vlerë 18,701 mijë lekë**, në regjistrimet e të cilave, përshkrimi nuk jep ose mungon plotësisht referenca e dy dokumenteve të rëndësishëm për vlerësim e rregullshmërisë së transaksionit siç është akt-kolaudimi dhe certifikata e marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve, dokument që lëshohet dhe konfirmon plotësimin e periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë për këtë grup regjistrimesh audituesi nuk mund të shprehet mbi rregullshmërinë e pagesave.

13.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të merren masa për pasqyrimin e saktë të dokumentacionit justifikues mbi të cilin bazohet urdhër-shpenzimi mbi çlirimin e garancisë së punimeve. Gjithashtu në vijimësi të njoftojë NPA në lidhje me rastet e konstatuara për shkeljen e afatit të çlirimit të garancisë, për marrjen e masave ndaj NP dhe NA që shkelin afatet ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pagesave të kryera në vitin 2021 për llogari të vitit 2020, u konstatua se në 26 raste në vlerën 19,229 mijë lekë, data e faturës së furnitorit i përket muajit janar 2021, veprim në kundërshtim me pikën 1 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 3, datë 18.01.2021 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 46, datë 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit të shtetit””, ku citohet: “Në pikën 19 të Udhëzimit nr. 46, datë 24.12.2020 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2020”, afati që nëpunësit autorizues të njësisë të qeverisjes së përgjithshme do të urdhërojnë kryerjen e shpenzimeve (faturat e furnitorit duhet të jetë gjeneruar brenda muajit dhjetor të vitit 2020) në muajin janar të vitit 2021 përcaktohet data 21.01.2021”. Pra kemi përdorimin e buxhetit të vitit 2020 për mbulimin e shpenzimeve të vitit 2021.

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të verifikojë rastet e konstatuara nga grupi i auditimit mbi regjistrimin dhe ekzekutimin e faturave të furnitorit të cilat i përkasin vitit 2021, ti raportojë këto raste tek NPA dhe të propozojë marrjen e masave ndaj punonjësve të degëve të thesarit që kanë kryer ekzekutimin e këtyre faturave.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Gjatë analizimit të të dhënave të SIFQ, u konstatuan gabime në plotësimin e të dhënave, dhe më konkretisht:

- Në 10 raste të regjistrimit të faturave, data e furnitorit është pas datës së regjistrimit;
- Në 2 raste të regjistrimit të kontratave, data e kontratës është pas datës së krijimit në SIFQ.
- Në 638 raste ka mospërputhje të datës së krijimit të pagesës (datë sistemi), me datën e regjistrimit (datë e hedhur manualisht).

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të vlerësojë mundësinë e implementimit të mekanizmit të kontrollit të inputit, me qëllim shmangien e gabimeve të evidentuara mbi

plotësimin e të dhënave. Gjithashtu të marrë masat për unifikimin e fushave së datës së krijimit të pagesës (datë sistemi) dhe datës së regjistrimit (datë e hedhur manualisht) me qëllim raportimin e saktë të kryerjes së veprimeve në sistem.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

a. Në degët thesarit nuk kanë përmbushur afatet dhe nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare 68 njësi, kryesisht njësi të qeverisjes vendore. Për rastet e dorëzuara me vonesë të pasqyrave financiare të institucioneve buxhetore, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2017, datë 02.06.2017, në nenet 62 dhe 71 të tij, nuk është vënë në zbatim nga nëpunësi i parë autorizues masë administrative, ose gjoha në masën 1-3 paga mujore”;

b. Sipas përcaktimeve të pikave 123, 124, 125 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", brenda muajit qershor të vitit pasardhës, për vitin ushtrimor të mbyllur hartohen pasqyrat financiare përmbledhëse të konsoliduara të qeverisjes së përgjithshme qendrore e vendore.

c. Midis pasqyrave fizike të dorëzuara nga institucionet buxhetore në degët e thesarit dhe pasqyrave financiare të gjeneruara nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), ka diferenca, si më poshtë:

-Në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ, pasqyrohen shpenzimet faktike të vitit, ndërsa në pasqyrat fizike (manuale) të institucioneve buxhetore pasqyrohen detyrimet e konstatuara dhe të papaguara, si pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo detyrimi për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit dhe paguhet me buxhetin e vitit të ardhshëm;

-Në pasqyrat financiare të gjeneruara nga SIFQ pasqyrohen arkëtimet e vitit, ndërsa në pasqyrat fizike të institucioneve buxhetore, pasqyrohen të drejtat e konstatuara dhe të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme, siç janë debitorët.

Për sa më sipër, Pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit nuk japin një pamje të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të Qeverisë dhe nuk u japin mundësinë përdoruesve të interesuar, të brendshëm dhe të jashtëm të marrin informacion të saktë e të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.

16.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit, të marrin masa për hartimin e një metodologjie për përgatitjen e saktë të pasqyrave të konsoliduara financiare të qeverisë në përputhje me rregullat bazë të kontabilitetit.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Detyrimet e prapambetura në fund të periudhës raportuese 31.12.2020, paraqiten në vlerën 14,316,778 mijë lekë ose 17% më ulët se në vitin 2019, detyrim i cili paraqitej në vlerën 17,371,031 mijë lekë. 30 nga 306 institucione të cilat kanë raportuar detyrime të prapambetura më 31.12.2020 (Ilogaria 4864 detyrime të prapambetura, sipas SIFQ) përbëjnë 78% të stokut total të detyrimeve ku veçojmë: Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve me 10% të stokut të faturave të prapambetura në vlerën prej 1,500,621 mijë lekë, Aparatin e Ministrisë së Infrastrukturës me 9% të stokut të faturave të prapambetura në vlerën prej 1,280,059 mijë lekë

dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me 6% të stokut të faturave të prapambetura në vlerën prej 857,248 mijë lekë.

Llogaria 4864 është detajuar me llogari analitike me qëllim regjistrimin dhe raportimin e detyrimeve të prapambetura tatimore dhe atyre të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Ndërkohë që, detyrimet për vendime gjyqësore ndërkombëtare nuk raportohen, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 27/02/2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. Duhet theksuar se mënyra e raportimit sipas formatit të strategjisë, i paraqet shifrat në mënyrë progresive dhe nuk japin pamje mbi shtesat dhe pakësimet që ka pësuar stoku i detyrimeve të prapambetura në bazë vjetore. Duke krahasuar stokun progresiv të raportimit të datës 31.12.2019 i cili paraqitet në vlerën 40,963,015 mijë lekë, me stokun progresiv të datës 31.12.2020 i cili paraqitet në vlerën 53,398,641 mijë lekë, konstatohet një rritje e tij në vitin 2020 me 12,435,626 mijë lekë. Detyrimi i mbetur neto në fund të vitit 2020, krahasuar me vitin 2019 konstatohet me pakësim 3,054,254 mijë lekë. Me qëllim vlerësimin e saktësisë dhe plotësisë së këtij raportimi në përputhje me VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, të ndryshuar u krahasuan të dhënat e raportuara nga njësitë, në zbatim të kësaj strategjie, konkretisht shumat e deklaruara “të paguara” gjatë vitit 2020 me të dhënat e SIFQ të vëna në dispozicion. Konstatohet se detyrimet e paguara sipas SIFQ rezultojnë në vlerën 14,518,078 mijë lekë ndërsa sipas raportit të MFE rezultojnë në vlerën 15,188,571 mijë lekë. Pra pagesat për faturat dhe detyrime të tjera rezultojnë 670,493 mijë lekë më pak se pagesat e raportuara. Nisur nga raportimet për gjendjen neto 31.12.2019, dhe përllogaritet e kryera nga grupi auditimit në lidhje me shtesën dhe pakësimet sipas raportimit, konstatohet se sipas raportit të pagesave vlera e përllogaritur e gjendjes neto të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2020 rezulton 14,618,085 mijë lekë ndërsa vlera e raportuar rezulton 14,316,777 mijë lekë. Për sa më sipër grupi i auditimit llogarit një vlerë prej 301,308 mijë lekë detyrime të prapambetura më tepër sesa raportimi.

Konstatohet 457 institucione nga 612, rezultojnë me diferenca në raportim si në vijim:

-156 institucione kanë kryer pagesa por s'kanë raportuar, me një diferencë në vlerën 2,557,527 mijë lekë.

-38 institucione kanë raportuar shuma më të vogla sesa pagesat e kryera, me një diferencë në vlerën 3,930,001 mijë lekë.

-263 institucione kanë raportuar shuma më të mëdha sesa pagesat e kryera, me një diferencë në vlerën 7,158,022 mijë lekë.

Një vlerë e konsiderueshme dhe me risk rezulton diferenca prej 2,896,917 mijë lekë midis raportimit të pagesave dhe pagesave sipas të dhënave nga SIFQ për Bashkinë Tiranë.

Nga 263 Institucione që kanë raportuar pagesa më tepër sesa pagesat faktike 119 prej tyre i kanë pagesat 0. Në përputhje me udhëzimin të MFE nr. 8 datë 09.03.2018, udhëzimit të MF nr. 5 datë 27/02/2014 Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura si dhe Manualin udhëzues “Mbi regjistrimin, ngarkimin dhe postimin në sistem të detyrimeve të prapambetura” më lart, detyrimi duhet të regjistrohet “*gjatë gjithë vitit financiar, menjëherë sapo institucioni buxhetor evidenton krijimin e një detyrimi te prapambetur*” në llogarinë 4864 detajuar sipas natyrës së detyrimit (investime, mallra etj.) Në momentin e pagesës me dërgimin e dokumentacionit në Thesar, veprimi i parë i regjistruar në llogarinë 4864 stornohet, fatura regjistrohet për herë të parë si transaksion shpenzimi dhe më pas paguhet. Nga auditimi i të dhënave të rifreskuara të kësaj llogarie në datën 14.04.2021, 101 institucione nuk rezultojnë në databazën e raportimeve as për pagesa as për detyrime të prapambetura për vitin 2019-2020, ndërkohë që pagesat sipas Thesarit rezultojnë në vlerën 1,893,179 mijë lekë.

Gjatë vitit 2020 shtesat më të larta të detyrimeve të prapambetura konstatohen në Aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me një shtesë detyrimi në vlerën 1,565,614 mijë lekë, ndjekur nga ARRSH me vlerën 1,139,328 mijë lekë, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në vlerën 883,045 mijë lekë, etj, ndërsa Institucionet me pakësimet më të larta të detyrimeve rezultojnë ARRSH me vlerën 4,287,522 mijë lekë, ndjekur nga Bashkia Kavajë me 697,969 mijë lekë, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime me vlerën 522,099 mijë lekë, etj.

Nga kryqëzimi i të dhënave u konstatua se Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Aparati i Ministrisë së Mbrojtjes kanë të njëjtën vlerë në raportimin progresiv të detyrimeve të prapambetura për 31.12.2020, në vlerën 883,045 mijë lekë. Kjo vlerë rezulton edhe në raportimin progresiv të detyrimeve të 31.12.2019 për Aparatin e Ministrisë së Mbrojtjes, ndërsa për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile jo. Për këtë të fundit kjo vlerë konstatohet shtesë gjatë vitit 2020, ndërkohë që për Aparatin e Mbrojtjes e njëjta vlerë rezulton pakësim. Si konkluzion Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile sipas raportimit rezulton me pakësim 25,797 mijë lekë ndërsa sipas modulit pagesa nuk rezultojnë pagesa për këtë vit. Nga ana tjetër Aparati i Ministrisë së Brendshme sipas raportimit rezulton me një pagesë prej 883,045 mijë lekë, ndërkohë që sipas modulit të pagesave, kjo e fundit rezulton vetëm 8,697 mijë lekë, duke sjell në këtë mënyrë një diferencë prej 874,348 mijë lekë midis raportimit të pakësimit të detyrimit të prapambetur për vitin 2020 me modulën e pagesave faktike. *Në konkluzion, të gjitha këto pagesa për detyrime të prapambetura janë kryer jashtë skemës së përcaktuar në udhëzimet përkatëse rrjedhur nga VKM nr. 50 datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të ndryshuar, Udhëzimit plotësues i MFE nr. 2 dt.20.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020" dhe Udhëzimit të MFE Nr. 35 datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme" (udhëzim i ri që ka ndikuar për 3-mujorin e fundit të vitit 2020).*

Nisur nga këto problematika konstatohet se procesi i raportimit tremujor nuk ka patur monitorim të plotë përgjatë vitit 2020. Shifrat e pagesave në pjesën më të madhe nuk është e mundur që të investigohen dhe verifikohen me modulën e pagesave për të parë nëse ato kanë kaluar përmes skemës 486, rrjedhimisht nuk mund të japim siguri në lidhje me shumën e raportuar në këtë llogari dhe në raportimet sipas strategjisë. Mënyra e kontabilizimit të stokut të faturave të prapambetura si "shpenzime të periudhave të ardhshme" vazhdon të jetë e njëjtë si në vitet e kaluara, në kundërshtim me standardet e kontabilitetit dhe me parimin e njohjes së shpenzimit në momentin e ndodhjes sipas Udhëzimit të MFE nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", pika 36 sipas të cilit shpenzimi njihet në momentin e ndodhjes/kryerjes. Kjo me impakt, deformim të pasqyrave financiare dhe treguesve fiskal: zëri shpenzime dhe rrjedhimisht deficitit buxhetor. Për sa më sipër nuk mund të japim siguri se stoku i faturave të prapambetura më 31.12.2020 është i saktë dhe i plotë.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit të marr masa me qëllim monitorimin dhe raportimin e saktë të detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi konstatohet se janë nënshkruar gjithsej 11 kontrata SWAP, nga të cilat tetë transaksione në EUR dhe tre në SDR. Kjo është ndikuar kryesisht nga niveli i lartë i tepricës së TSA në valutë të huaj, që ka pakësuar nevojën për kryerjen e operacioneve të sigurimit të valutës për pagesat në monedhë të huaj. Instrumentet në dispozicion për mbulimin e nevojave në lekë nga valuta janë SWAP dhe Outright, nga të cilat konstatohet se

është gjeneruar një humbje financiare prej 190 milionë lekë nga përdorimi i instrumentit SWAP dhe 49 milionë lekë nga instrumenti Outright.

Grupi i auditimit ka analizuar flukset hyrëse dhe dalëse të mjeteve monetare në llogarinë e TSA-së të të gjitha valutave (SDR, EURO, dhe Lekë), duke evidentuar balancat e tyre në ditët e nënshkrimit të kontratave spot - forward në të treja monedhat e huaja si dhe në monedhën vendase. Sipas analizës së të dhënave dhe të Cash-Flow 2020, identifikohen rastet ku bëhen konvertim i panevojshëm i fondeve për arsye se në datën e maturimit nuk ka qenë i mjaftueshëm likuiditeti në Lekë për plotësimin e llogarisë në Euro sipas urdhrin të vetë DPTH, dhe për këtë arsye, po në të njëjtën datë, urdhërohet nga DPTH një tjetër kontratë në monedhë të huaj, emetimi i së cilës do të përmbush nevojën për cash-in në Lekë. Duke qenë se në disa raste, TSA në Lekë ka qenë e pamjaftueshme për përballimin e konvertimit nga LEK në Euro (maturimi i kontratës) dhe kjo ka krijuar kushtet për lidhjen e kontratës së re (fillim kontrate) duke krijuar lëvizje në Euro që janë shoqëruar me kosto nga konvertimi i kursit të këmbimit, në kushtet që nevoja reale për Euro ka qenë në të gjitha rastet ndjeshëm më e ulët se konvertimi i realizuar.

Kjo situatë vjen për shkak të paracaktimit të ushtrimit të Swap pa identifikuar nevojën reale për konvertim për pagesat përkatëse të muajit në Euro, duke kryer konvertim të panevojshëm të fondeve duke qenë se në datë të maturimit nuk ka qenë i mjaftueshëm likuiditeti në Lekë për plotësimin e llogarisë në Euro sipas urdhrin të vetë DPTH.

18.1 Rekomandimi: Nga ana e MFE të merren masa për kryerjen e operacioneve të njëanshme të konvertimit të monedhës së huaj në blerje dhe në shitje me kursin e ditës spot nëpërmjet ripërcaktimit të termave të marrëveshjes aktuale me Bankën e Shqipërisë në rolin e agjentit fiskal të qeverisë dhe/ose me bankat e nivelit të dytë. Në varësi të flukseve hyrëse dhe dalëse monetare të evidentohet për çdo rast, arsyetimi i përdorimit të instrumentit SWAP dhe Outright përkundrejt konvertimit të thjeshtë në tregun e këmbimit valutor nëpërmjet ofertave të gjithë pjesëmarrësve të tregut.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Gjatë shqyrtimit të të dhënave të burimeve njerëzore për vitin 2020, të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Procesimit të Biznesit, u konstatua se, **në 5 raste** punonjësit të cilët i kanë shkëputur marrëdhëniet e punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit ose me Degët e Thesarit në Rrethe, mbyllja si përdorues në sistemin SIFQ është kryer me vonesë dhe në **3 raste** rezultojnë të pambyllur, pra aktivë. Mbyllja e përdoruesve në sistem është kryer me vonesë nga 15 ditë deri në 7 muaj pas shkëputjes së tyre. Me risk evidentohet rasti i dy përdoruesve, të cilët janë pezulluar nga detyra dhe gjendja e tyre është aktive në sistemin SIFQ.

19.1 Rekomandimi: Sektori i Zhvillimit Funkcional të SIFQ, në Drejtorinë e Procesimit të Biznesit, të marrë masa të menjëhershme në verifikimin e kërkesave, për çelje dhe mbyllje përdoruesi, delegimit të funksioneve ose ndërrimit të përgjegjësive në sistem, në rast të ndryshimit të pozicionit të punës apo largimit nga detyra e punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Realizimi i pagesave të fondit të ish të përndjekurve politikë sipas tre evidencave që janë : Tabela Fiskale (SIFQ), sistemi elektronik E-dëshmperblime dhe Bankat e nivelit të dytë rezultojnë me diferenca, pasi sipas Tabelës Fiskale realizimi i pagesave për ish të përndjekurit politikë ka qenë në vlerën **1,001,529 mijë lekë**. Në llogarinë 6060019 të fondit për ish të përndjekurit politikë, të pasqyruar në SIFQ është përfshirë edhe fondi për Institutin e Ish të Përndjekurve Politikë.(1,000,000 mijë + 37.2 mijë). Sipas sistemit elektronik e-dëshmperblime

vlera e pagesave për vitin 2020 është **996,517 mijë lekë**. Sipas bankave të nivelit të dytë pagesat për të përndjekurit kanë qenë në vlerën **999,564 mijë lekë**. Konkretisht, ka një diferencë prej **5,012 mijë lekë** midis realizimit të Tabelës Fiskale dhe sistemit elektronik e-dëmshtëpërblime. Ka një diferencë prej **3,047 mijë lekë** midis realizimit të bankave të nivelit të dytë dhe realizimit sipas sistemit e-dëmshtëpërblime dhe një diferencë prej **1,965 mijë lekë** midis realizimit të deklaruar në tabelën fiskale dhe bankat e nivelit të dytë.

20.1 Rekomandimi: -Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshtëpërblimeve duhet të bëjë propozime dhe sugjerime për përmirësimin e sistemit e-dëmshtëpërblime, në dobi të punës së tyre të përditshme dhe duke bërë më të saktë dhe transparente pagesat e këtij fondi.

-Llogaria e fondit të ish të përndjekurve politikë të jetë e veçantë, të mos kryhen edhe pagesa të tjera nga kjo llogari.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi u konstatua se fondet e kthyer nga bankat e nivelit të dytë për vitin 2020, janë në shumën **878 mijë lekë**, në rastet kur përfituesit e fondit kanë probleme me llogaritë e tyre bankare (joaktive). Këto pagesa rezultojnë si “pagesa për thesarin” në statement-at bankar dhe janë kontabilizuar në muajt e parë të vitit 2021 si të ardhura për thesarin, të cilat regjistrohen në llogarinë e të ardhurave, si të ardhura nga viti i mëparshëm.

- Nga auditimi i rakordimit të bankave sipas muajve të vitit 2020, u konstatua se, A. Bank në muajin dhjetor 2020, nuk ka kryer pagesën me vlerën 200 mijë lekë të përfituesit të fondit (përfituesit e kishte llogarinë joaktive), banka nuk ka njoftuar, por as nuk e ka kthyer brenda 24 orëve në drejtorinë përgjegjëse, për pagesat e ish të përndjekurve politikë. Me shkresën nr. 22198 datë 24.02.2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i është drejtuar A. Bank për të kthyer fondin prej 200 mijë lekë, të cilin e mbajti 3 muaj gjendje në balancë. Ky fond është çelur nga Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshtëpërblimeve në muajin nëntor 2020 dhe meqenëse kaloi periudhën buxhetore, u kontabilizua në llogarinë e të ardhurave në muajin mars 2021. Për rrjedhojë, ky fond konsiderohet i djegur, pasi nuk mund të ripërdoret në vitin aktual.

21.1 Rekomandimi: Të minimizohet periudha e qëndrimit të pagesave të kthyer dhe reflektimi i këtij shpenzimi të anuluar në treguesit fiskalë mbi fondin e ish të përndjekurve politikë, në mënyrë që të pasqyrohet qartë dhe saktësisht vlera e pagesave të kryera për ish të përndjekurit e regjimit komunist. Të rishikohet akt marrëveshja midis Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe A. Bank (bankave të nivelit të dytë), ku penaliteti për mos pagesa apo mbajtje të fondit në balancat e bankës të jetë me kamatë për çdo 24 orë.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar “Auditim Përputhshmërie i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për vitin 2019”, miratuar me vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë Shtetit nr. 106 datë 27.10.2020, rezultoi se nga 21 rekomandime të lëna në auditimin e vitit 2019, janë pranuar 15 rekomandime nga të cilat 2 janë në proces zbatimi, 6 janë pazbatuar, 3 janë zbatuar pjesërisht dhe 4 rekomandime janë zbatuar.

22.1 Rekomandimi: Nisur nga niveli i zbatimit të rekomandimeve si dhe ekzistenca e fenomeneve në thyerje të sistemeve të kontrollit të disiplinës buxhetore dhe fiskale, ri kërkojmë pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pa pranuar si dhe të atyre të pranuar por të pazbatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil”.

Për punonjësit e identifikuar me përgjegjësi për shkeljet e konstatuara, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

K R Y E T A R

Arben SHEHU